



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:260726  
Datë: 20.03.2020  
Numri i dokumentit: 00901209

**A.nr.1015/17**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit “M...” SHPK, me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e aktvendimit nr.01.3.2.2/316 i datës 26.05.2017, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit av.S.B. dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Kushtrim Kastrati, me datë 03.03.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET e bazuar** kërkesëpadia e paditësit “M...” SHPK, me seli në Ferizaj.
- II. Anullohet aktvendimi nr.01.3.2.2/316 i datës 26.05.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin kontestues nr.01.3.2.2/316 i datës 26.05.2017, e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.R-9316/11.05.2017, të Zyrës së Brendshme Doganore Ferizaj, me të cilin paditësit i është rivlerësuar malli i deklaruar për zhdoganim.

Paditësi përmes të autorizuarit, me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 16.06.2017 ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale sepse nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore, për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, sepse është konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendja faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit kontestues, si dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kthej shumën prej 3,450.08€, me kamatë ligjore prej 8% nga data 14.06.2017 e deri në kthimin e kësaj shume.

Më tej paditësi në padi ka theksuar se me rastin e paraqitjes së mallit doganor, deklaratës unike doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse që kërkohen dhe që duhet bashkangjitur DUD-it konform nenit 66 të KDAK-së, respektivisht nenit 123 të UA nr.11/2009 për Implementimin

e KDAK-së nr.03/L-109, dhe atë fatura e mallit me nr.20171861 e datës 04.05.2017, deklarata eksportuese, dokumenti EUR.1, transferi bankar i datës 28.04.2017, DUD-at që Dogana ka pranuar çmimin e njëjtë të paraqitur nga i njëjti eksportues.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se aplikimi i metodës së tretë të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të KDAK-së është veprim që bie ndesh me nenet 33 dhe 35 të KDAK-së, për arsye se metoda e radhës e vlerësimit gjegjësisht metoda e tretë e vlerësimit, për tu aplikuar në rastin konkret është dashur të jepen arsye dhe prova për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor. Andaj nga të lartcekurat lehtë konstatohet se e paditura ka nxjerrë vendimin me aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. E autorizuar e paditësit në seancë e ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës me nr.01.3.2.2/316, dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia kthej shumën prej 4,386.04€ nga data 14.06.2017, me kamatë vjetore prej 8% deri në kthimin e kësaj shume. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 01.10.2019, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë në shkelje ligjore nuk qëndron fare, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se edhe më tutje e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Konsideron se vendimi i marr nga Dogana e Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm dhe i njëjti i referohet dispozitave të nenit 34 paragrafi 2 pika b) të KDAK-së, dhe se për bazë gjatë rivlerësimit të mallit në fazën e zhdoganimit, Dogana e Kosovës ka marr të dhënat të cilat i referohen mallrave të ngjashme dhe të cilat kanë si dërgues shtete të Bashkimit Evropian. Gjatë fazës së zhdoganimit Dogana e Kosovës nuk ka mohuar faktin se paditësi ka paraqitur dokumentacion me të cilin pretendon se çmimet e paguara për mallin kontestues janë reale, por nga të dhënat që Dogana i dispononte përkatësisht duke iu referuar deklaratës R-1863 të datës 20.03.2017, çmimet ishin shumë më të larta se sa ato të prezantuara nga ana e paditësit. Po ashtu dokumentacioni përcjellës i prezantuar është konsideruar i pamjaftueshëm dhe jo i plotë ku ndër të tjera paditësit i mungonte kontrata e shitblerjes së mallit me të cilin do të vërtetonte se çmimi i paguar për mallin e ri vlerësuar është real e po ashtu transferi bankar i prezantuar përkundër faktit se ka vlerë të njëjtë i referohet një pro fature dhe jo faturës së bashkangjitur në procedurën e zhdoganimit. Andaj mbi bazën e të theksuarave si më sipër konsideron se vendimi është i bazuar dhe i ligjshëm dhe i propozoj gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësi dhe ta lë në fuqi vendimin e Doganës së Kosovës si të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 03.03.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: Aktvendimin me nr. 01.3.2.2/316 i datës 26.05.2017, Ankesën e paditësit të ushtruar tek e paditura të datës 15.05.2017, Deklaratën Doganore R-9316 të datës 11.05.2017 në versionin e paraqitur nga paditësi dhe të ndryshuar nga e paditura, Pagesën e Detyrimeve Importuese Doganore nga paditësi të datës 12.05.2017, Faturën e Blerjes me nr.20171861 të datës 04.05.2017, Certifikatën e Origjinës së mallit EUR-1 të datës 04.05.2017, Deklaratën Eksportuese të datës 08.05.2017, Faturën e Shpenzimeve të Transportit me nr.1860/17 të datës 11.05.2017, Deklaratën e Transitit të datës 11.05.2017, Urdhërpagesën Bankare Ndërkombëtare të datës 28.04.2017, Deklaratën Doganore R-25858 të datës 14.12.2016, Deklaratën Doganore referuese R-1863 të datës 20.03.2017, Procesin e datës 12.05.2017.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 38 të LKA-së nr.03/L-202, në seancën e mbajtur me datë 03.03.2020, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimi të shkresave

të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga DUD-i kontestues i Doganës së Kosovës R-9316 i datës 11.05.2017, Procesi Mbi përcaktimin e Vlerës së Mallrave i datës 12.05.2017, si dhe aktvendimi kontestues, ka nxjerr konstatimin se paditësi ka deklaruar mallin lëndor “*Dyer me elemente (brava, dorëza)*”, me dimensione 90x200cm total 149 pce dhe korniza për dyer me dimensione 90X200cm në total 40pce”, për zhdoganim në Zyrën e Brendshme Doganore në Ferizaj, me ç’rast pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-it kontestues dhe dokumentacionit përcjellës të mallit, Dogana e Kosovës-Zyra e Pranimit Qendror me arsyetimin se vlera e mallit për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar me qëllim importi në Kosovë, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, ka rivlerësuar mallin në bazë të metodës së tretë të vlerësimit, në mbështetje të nenit 34 par.2 pika b), bazuar në çmimin për mallrat nga tregu i njëjtë ai i Bashkimit Europian, të marruara nga DUD-i R-1863 i datës 20.03.2017. Si rezultat i kësaj e paditura e ka detyruar paditësin të paguaj detyrime importuese doganore në vlerë më të lartë se të deklaruar me faturën e mallit me nr.20171861 të datës 04.05.2017.

Nga aktvendimi i kontestuar gjykata vëren se ai përmban të meta të tilla, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla konsistojnë në atë se arsyetimi i vendimit kontestues përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor, sikurse aktvendimi kontestues nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore. Gjykata vlerëson se e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm dhe të bazuar se përse paditësit nuk i është pranuar deklarimi mallrave sipas faturës dhe transaksionit bankar, në bazë të metodës së parë të vlerësimit.

Gjykata gjithashtu vëren se e paditura nuk ka ofruar asnjë provë për të dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit të mallit, mbi çmimin e faturës të mallit, në mënyrë që të provohet konstatimi i dhënë në vendimin e kontestuar se vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim, nuk është vlera reale e mallit dhe se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar.

Arsyetimi i të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit i paraqitur nga paditësi është vlerësuar i pa mjaftueshëm, për arsye se mungon kontrata e shitblerjes e cila do ta forconte bindjen e Doganës lidhur me vlerën reale të mallit, për gjykatën është arsyetim tërësisht i pa bazuar, sepse e paditura në vendimin e kontestuar nuk ka qenë në gjendje të sqaroj se mbi bazën e cilës dispozitë ligjore të legjislacionit doganor të aplikueshëm, parashihet që një dokument i tillë duhet që ti bashkëngjitet deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë. Për më tepër, nga shkresat e lëndës gjykata vëren se e paditura në procedurë të zhdoganimit të mallit, nuk ka vepruar sipas kërkesave ligjore, për arsye se nuk ka kërkuar dokumente tjera shtesë nga paditësi për të vërtetuar saktësinë e të dhënave nga deklarata doganore dhe nuk e ka njoftuar paditësin në formë të shkruar për dyshimin se vlera e deklaruar e mallit nuk është vlera reale e paguar, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 72 të KDAK-së dhe nenit 92 të UA nr.11/2009.

Gjykata konstaton se në Procesverbalin Mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave të datës 12.05.2017 (procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike), i cili gjendet në shkresat e lëndës, në të cilin e paditura e ka bazuar rivlerësimin e mallit për paditësin, nuk ka përkrahje të mallit, nuk dihet origjina e mallit, nuk dihet kualiteti i mallit dhe të dhënat tjera të kërkuara për mallrat e ngjashëm siç përcaktohet me nenin 61 pika d) të UA.nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109. Në lidhje me mallin e ngjashëm të zhdoganuar përmes DUD-it R-1863/20.03.2017, ku e paditura e ka bazuar ri vlerësimin e mallit për paditësin, gjykata konstaton se ky mall është eksportuar nga Sllovenia e jo nga Gjermania sikurse malli i importuar nga paditësi, dallon lloji i mallit sepse siç

shihet nga përshkimi i mallit dyert dhe kornizat e importuara nga Sllovenia janë me iver pllakë, pra nuk është e njëjta cilësi e mallit, dallon periudha kohore e importit, rrjedhimisht është e natyrshme që dallon edhe çmimi i mallit, prandaj të gjitha këto bëjnë që në këtë rast nuk mund të aplikohet metoda e tretë e vlerësimit të mallit, në kuptim të nenit 34 par.2 pika b) e KDAK-së nr. nr.03/L-109, siç ka vepruar e paditura.

Në anën tjetër, gjykata konstaton se paditësi në këtë procedurë të konfliktit administrativ ka paraqitur si provë për DUD-in R-9316/11.05.2017, faturën e mallit me nr.20171861 të datës 04.05.2017, Certifikatën e Origjinës ë Mallit Euro.1 të datës 08.05.2017, Deklaratën Eksportuese të datës 08.05.2017, Deklaratën e Transitit të datës 11.05.2017, si dhe Pagesën Bankare Ndërkombëtare të datës 28.04.2017. Gjykata vlerëson se gjitha këto dokumente nuk janë shqyrtuar nga e paditura nëse janë të harmonizuara sa i përket vlerës së mallit të importuar dhe çmimit të paguar, në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së dhe nenit 123 të UA.nr.11/2009, andaj për gjykatën kjo është e pa pranueshme, sepse e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues nuk ka dhënë shpjegime ligjore dhe faktike për vlerësimin e mallit dhe se në pikat esenciale nuk janë vërtetuar faktet plotësisht, siç edhe për faktet e vërtetuara e paditura ka nxjerr konkluzion jo të drejtë të gjendjes faktike.

Po ashtu gjykata konstaton se paditësi për të provuar vlerën e deklaruar të mallit, në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore, ka paraqitur si provë DUD-in R-25858 të datës 14.12.2016, nga ku shihet se e paditura për të njëjtin mall, nga eksportuesi i njëjti nga Gjermania, paditësit i ka njohur vlerën e deklaruar të mallit sipas metodës së parë të vlerësimit në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Gjykata thekson se në nenin nenit 33 paragrafi 1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”*. Në frymën e këtyre dispozitave ligjore, duke pasur parasysh edhe nenin 123 par.1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave, ku parashihet që *“ Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*, gjykata konstaton se e paditura në mënyrë të gabuar në rastin konkret ka kaluar nga metoda e parë e vlerësimit në metodën e tretë, kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi, pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar dhe të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dëshmuar edhe vlerën doganore të mallit të importuar dhe çmimin vërtetë të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ, për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmerisë së vendimit të kontestuar dhe se arsyetimi i të paditurës se Zyra e Pranimit ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim importi në vendin tonë, për gjykatën është i pa bazuar dhe nuk mbështetet në asnjë dëshmi konkrete mbi vlerën reale doganore të mallit të importuar nga paditësi. Së këndejmi, gjykata përsërit se e paditura nuk duhet të kalojë në metodën e tretë të vlerësimit, pa u vlerësuar metodat

paraprake të vlerësimit, respektivisht pa u vlerësuar dokumentacioni i prezantuar nga paditësi në raport me kërkesat ligjore.

Prandaj, gjykata e obligon të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje, të deklarohe lidhur provat e paraqitura nga paditësi dhe të administruara nga gjykata e të cilat u përmenden më lartë. Gjykata kërkon nga e paditura që në ri procedurë para se të aplikoj të dhënat për mallin e ngjashëm, të vlerësoj metodat paraprake të vlerësimit gjegjësisht metodën e parë, të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit përcjellës të mallit në aspektin e harmonizimit të vlerës së mallit të deklaruar, ashtu që të shqyrtoj pretendimet e paditësit se a ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 Për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, pastaj të verifikohet vlera e paguar e faturës për mallin e importuar sipas transaksionit bankar dhe nëse ajo harmonizohet me vlerën e deklaruar, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor.

Në ri procedurë e paditura të sqaroj se me cilën dispozitë ligjore kërkohet paraqitja e kontratës së shitblerjes së mallit në procedurën e zhdoganimit të mallit si dhe të sqaroj faktin se si është e mundur që për DUD-in R-1863 të datës 20.03.2017, paditësit i ka njohur vlerën e deklaruar të mallit nga eksportuesi i njëjtë ndërsa në rastin konkret jo. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave, duke pasur parasysh edhe praktiken doganore në rastet e ngjashme. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal**  
**A.nr.1015/17, datë 03.03.2020**

**Zyrtarja Ligjore**  
Asliha Fejzullahu

**Gj y q t a ri**  
Rexhep Gashi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.